



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 0077 prot.

Tiranë, më 11.04.2026

NJOFTIM

PËR VEND PUNE TË PËRKOHSHËM (ZËVENDËSIM LEJE LINDJE)

**SPECIALIST I SEKTORIT TË ADMINISTRIMIT TË PROVIMEVE, NË DREJTORINË E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE
DHE PERFORMANCËS ARSIMORE, PRANË QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE**

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr., 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr.32, datë 18.02.2025, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore", Qendra e Shërbimeve Arsimore njofton shpalljen e vendit të lirë të punës:

1. Në pozicionin specialist në Sektorin e Administrimit të Provimeve, në Drejtorinë e Vlerësimit të Arritjeve dhe Performancës Arsimore . Ai/Ajo punon nën drejtimin e Përgjegjësit të Sektorit, Drejtorit të Drejtorisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA-së, si pjesë e ekipeve të punës brenda institucionit dhe bashkëpunon me pjesëtarët e tjerë të stafit. Përgjegjësitë e pozicionit përfshijnë një gamë të gjerë të çështjeve të cilësisë, në fushën e vlerësimit të arritjeve, të përpunimit të të dhënave, administrimit dhe menaxhimit të provimeve/vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Kualifikimet, aftësitë dhe eksperiencat që kërkohen për këtë vend pune janë:
 - ✓ Diplomë universitare Bachelor, preferohet në informatikë.
 - ✓ Përvojë pune mbi 1 vit.
 - ✓ Të ketë njohuri dhe aftësi të mira komunikimi në një nga gjuhët e BE (preferohet gjuha angleze).
 - ✓ Të ketë aftësi shumë të mira në përdorimin e programeve bazë kompjuterike si paketa office;
 - ✓ Të punojë vazhdimisht për zgjerimin e njohurive shkencore, profesionale dhe menaxheriale në mënyrë të dokumentuar;
 - ✓ Të ketë njohuri mbi shkrimin akademik.
 - ✓ Të ketë aftësi të të dëgjuarit, të shkrimit dhe të folurit në mënyrë efektive.
 - ✓ Të ketë aftësi në përdorimin në mënyrë efektive të dhënave informatike.
 - ✓ Të ketë aftësi për të punuar në ekip dhe për të marrë iniciativë.
 - ✓ Të ketë aftësi për të punuar nën presion dhe me afate të ngushta kohore.
 - ✓ Të ketë aftësi të ndjekë dhe menaxhojë disa detyra në të njëjtën kohë.
 - ✓ Të tregojë përkushtim ndaj misionit dhe qëllimeve të Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Paga për pozicionin është në kategorinë IV-2.

3. Paraqitja e dokumenteve: Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 05.05.2026 në sekretarinë e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me adresë, QSHA, Bulevardi Zhan D'Ark nr. 23, Tiranë, këto dokumente: Kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave, fotokopje të librezës së punës, fotokopje të certifikatave të kualifikimit, dëshmime të gjuhëve të huaja dhe të kompjuterit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, raportin mjekësor për aftësinë në punë, të paktën një letër rekomandimi, një numër telefoni për t'u kontaktuar, si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

Njoftimi për shpalljen e këtij vendi të lirë pune mund të gjendet edhe në faqen zyrtare të QSHA-së www.qsha.gov.al

DREJTOR I PËRGAJTHSHËM

Aida Myrto

